



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 43
Prishtinë, më 01 mars 2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Fikrim Damka.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.2.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, i ftuar z.Skender Hyseni, Ministër;
4. Diskutimi i planit për shqyrtimin e raporteve të Auditimit të Komunave;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.2.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 23.2.2017, u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për PVF-të e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët dhe të pranishmit se Ministri i MPB-së nuk ka mundur të jetë prezent në takim, për shkak të agjendës që ka pasur, dhe pse kjo është hera e dytë që ministri ishte i ftuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Po ashtu kërkoi nga deputetët që të shqyrtohet raporti i auditimit për MPB-në, dhe të vazhdojnë diskutimi edhe pa prezencën e ministrit. Me këtë hapi diskutimin.

Abdyl Ymeri, theksoi se është mirë të kordinohen më mirë sekretaria e KMFP-së me kabinetin e ministrit për caktim të datës dhe kohës së takimit.

Ali Sadriu, kërkoi që NE si komision duhet ti përshtatemi agjendës së ministrit dhe po ashtu, theksoi se nuk e di çfarë kriteri është përdorur nga ana e komisionit që është përzgjedhur, Raporti i Auditimit për Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 për MPB-në . Ky raport ka opinionin e pamodifikuar dhe nuk është dashur të renditet për shqyrtim në Komision.

Enver Hoti, po ashtu kritikoi për jo seriozitetin e ministrit për mos ardhjen në komision, ndërsa në punën e raportit të Auditorit theksoi disa mangësi që raporti ka pasur, disa prej pikave që z. Hoti theksoi ishin: vonesa në realizimin e projekteve, shpenzime pa procedura të prokurimit etj.

Synavere Rysha, lavdëroi punën e Auditorit me ç'rast kërkoi që në takimet e ardhshme të bëhet një agjendë e përbashkët me ministrin, dhe të merren vendimet në prezencën e ministrit.

Hajdar Beqa, theksoi se raporti auditimit për MPB-në është opinion i pamodifikuar (realisht i mirë), dhe kërkoi nga Kryetari dhe sekretaria e komisionit që kur të vendoset për rendin e ditës të ketë një pajtueshmëri edhe me ministrin e MPB-së, paraprakisht.

Faton Topalli, kryetar, kërkoi që në takimet e radhës së komisionit, raportet e auditimit të institucioneve të shqyrtohen pa prezencën e ministrave, nëse ata refuzojnë pjesëmarrjen në takim disa herë radhazi.

Përfundimi

KMFP, vendosi që raporti i auditimit të PVF-ve të MPB-së, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

4. Diskutimi i planit për shqyrtimin e raporteve të Auditimit të Komunave

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët për punën e bërë deri tani lidhur me shqyrtimin e raporteve të auditimit të rregullsisë të komunave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015. Me këtë hapi diskutimin.

Zukë Zuka, përfaqësues nga ZKA, theksoi se pikat e propozuara për hulumtim dhe për shqyrtim i ka konsideruar shumë të mira, e në veçanti fokusi ishte në pikën (a,c,d,g,h), ku auditorët kanë pasur paqartësi, po ashtu shprehu gaditshmërin për përgaditjen e komenteve të raporteve të Komunave nga ana e Komisionit.

Enver Hoti, kërkoi nga komisioni të punohet më shumë në këtë fushë, sidomos nga komunat që kanë buxhet të ndarë për Investimeve Kapitale.

Faton Topalli, kryetar, propozoi që mbledhje mbledhja e radhës së komisionit të mbahet me 22 mars 2017, për ti shqyrtuar raportet e Auditimit për 8 komuna si: Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Graçanicë. Ndërsa komentet në raportet e auditimit të dorëzohen nga ZKA në komision me 15 mars 2017.

Përfundimi

KMFP, vendosi që me 22 mars 2017 të ftoi tetë (8) Kryetarë të komunave për të diskutuar Raportet e Auditimit të PVF-ve për këto komuna për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015. Po ashtu në këtë mbledhje të komisionit u vendosë të ftohen edhe Ministri i MF-së, Ministri i MAP-së dhe Ministri i MAPL-së.

5. Të ndryshme.

Bali Muharremi, kërkoi nga Zyra e Auditorit, një Auditim të performancës për Radio Televizionin e Kosovës, me arsyetim se Raporti Vjetor i Punës bashkë me Pasqyrat Financiare për vitin 2015, nuk janë aprovuar në seancë plenare.

Ali Sadriu, theksoi se kërkesa është e drejtë, mirëpo me Ligjin për RTK-në, nuk lejohet të bëhet auditim i PVF-ve të RTK-së nga ana e ZKA-së. Ne mund të kërkojmë një auditim të performancës së RTK-së, nga ana e ZKA-së.

Enver Hoti, njoftoi deputetët se Kuvendi ka marrë një vendim ditë më parë për themelimin e një komisioni hetimor për RTK-në. Pyeti pse nuk po bëhet funksional ky komision hetimor, ku janë pengesat.

Naim Fetahu, theksoi se sa i përket komisionit hetimor, ne si KMFP nuk mund të japim përgjigjeje në këtë, për këtë duhet të merret përgjigjja në seancë plenare.

Hajdar Beqa, theksoi se ZKA-së duhet ti drejtohem me kërkesë për të përfshirë në planin e punës përveç tjerash edhe auditimin e performancës së RTK-në.

Faton Topalli, kryetar, propozoi që komisioni t'i drejtohet Zyrës Kombëtare të Auditimit me një shkresë, me të cilën kërkohet të bëhet një auditim i performancës së RTK-së.

Përfundim

KMFP, vendosi që Zyra Kombëtare e Auditimit, të bëjë auditimin e performancës të Radiotelevizionit Publik të Kosovës.

Takimi përfundoi në ora 12:30

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli